



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 131/5 Prot.

Tiranë, më 24/02/2025

NJOFTIM

“MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË APLIKIMIT PËR PËRFITIMIN E FINANCIMEVE NGA BUXHETI I SHTETIT, TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA NGA MINISTRI I DREJTËSISË “PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI””

Në mbështetje të nenit 15 të ligjit Nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”, Ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Vendimit Nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, ndryshuar me VKM nr. 227, datë 23.04.2023, Kreut VI të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas” miratuar me Urdhër nr. 393 datë 23.11.2020, të Ministrit të Drejtësisë, Urdhrit nr. 74, datë 28.01.2025, të Ministrit të Drejtësisë “Për ngritjen e komisionit vlerësues për shqyrtimin edhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara dhe të komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të organizatave jofitimprurëse të autorizuara”, Metodologjisë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, miratuar me Urdhër nr. 4 datë 07.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, **Komisioni i vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara, pas shqyrtimit të detajuar të dosjeve të organizatave jofitimprurëse**

VENDOSI:

1. **Pranimin e kërkesës** për përfitim financimi të organizatës jofitimprurëse të autorizuar “*Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza*”, në vlerën e kërkuar 1,282,206 lekë, me vendimin Nr. 3, datë 20.02.2025.
2. **Pranimin e kërkesës** për përfitim financimi të organizatës jofitimprurëse të autorizuar “*Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin*”, në vlerën e kërkuar 767,400 lekë, me vendimin Nr. 5, datë 20.02.2025.
3. **Pranimin e kërkesës** për përfitim financimi të organizatës jofitimprurëse të autorizuar “*Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, (TLAS)*”, në vlerën e kërkuar 1,372,392 lekë, me vendimin Nr. 2, datë 20.02.2025.

4. **Pranimin e kërkesës** për përfitim financimi të organizatës jofitimprurëse të autorizuar “Qendra Psiko -Sociale Vatra” në vlerën e kërkuar 1,235,153 lekë, me vendimin Nr. 4, datë 20.02.2025.
5. **Refuzimin e aplikimit** për financimin të Organizatës jofitimprurëse “ALTRF”, me vendimin Nr. 9, datë 20.02.2025, në kushtet kur:
- Njëri prej anëtarëve të organit drejtues të organizatës është në proces hetimi nga ana e prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë për veprën penale “Falsifikim dokumentacioni”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal; Mosqënia e anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe organit ekzekutiv të organizatës në një proces hetimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike është një ndër kriteret e përgjithshme, mosekzistenca e të cilit passjell revokimin e autorizimit nga ana e Ministrit të Drejtësisë; Vepra penale e falsifikimit të dokumentacionit, nisur nga elementët e anës objektive dhe subjektive klasifikohet në ato vepra penale të cilat cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike.
6. **Refuzimin e aplikimit** për financimin të Organizatës jofitimprurëse “IMZHF”, me vendimin Nr. 8, datë 20.02.2025, në kushtet kur:
- Mospasja e dy burimeve të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet është një ndër kriteret e përgjithshme, mungesa e të cilit çon në skualifikimin automatik të kërkesës për financim; Drejtori Ekzekutiv i organizatës jofitimprurëse IMZHI me deklaratën nr. 17 prot., datë 01.02.2025, shprehet se organizata është shpallur fituese në një projekt për ndihmën juridike falas në shkallën e parë dhe ndërmjetësimin; Referuar ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” parashikon si një ndër format e ndihmës juridike parësore dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve.
7. **Refuzimin e aplikimit** për financimin të Organizatës jofitimprurëse “Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”, me vendimin Nr. 6, datë 20.02.2025, në kushtet kur:
- Targeti i përcaktuar në formularin e aplikimit të përcjellë nga ana e organizatës është nën parashikimet e targetit minimal të vendosur në thirrjen për aplikim të shpallur nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas; Nga ana e organizatës është përcjellë vetëm formulari TIP i aplikimit për projekt dhe deklarata që nuk ka 2 burime të njëjta financimi, duke mos përcjellë asnjë prej dokumentacionit të kërkuar në thirrjen për financim botuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 1/2025.
8. **Refuzimin e aplikimit** për financimin të Organizatës jofitimprurëse “Qendra e Gruas Hapa të Lehtë”, me vendimin Nr. 7, datë 20.02.2025, në kushtet kur:
- Kërkesa për financim nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm edhe pas kërkesës së Komisionit të Vlerësimit për plotësim dokumentacioni, referuar pikës 7/1 të VKM nr. 110, datë 6.3.20219, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, ndryshuar me VKM nr. 227, datë 23.04.2023 dhe konkretisht:

- Deklaratë ku të specifikohet vlera totale e fondit për secilin projekt të njëjtë/ngjashëm të përcjellë nga organizata në kuadër të procedurës së autorizimit për vitin 2024;
- Kopje e kontratës së grantit të lidhura me partnerë sa i përket projektit të deklaruar: “Mbështetje për barazinë gjinore, të drejtat dhe fuqizimin ekonomik të grave rurale në Shqipërinë e Veriut” .

Vendimi i komisionit vlerësues mund të ankimohet pranë komisionit të ankimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i rezultateve për shkelje të procedurave, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 110 datë 06.03.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, të ndryshuar.

Sekretariati Teknik

